



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA SHËNDETËSORE NR.2  
SHKODËR

Nr. 2485 Prot.

Shkodër, më 20 / 02 / 2023

Nr. 41 Prot.

Shkodër, më 20 / 02 / 2023

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET  
BASHKISË SHKODËR  
DHE**

**QENDRËS SHËNDETËSORE NR.2, AMBULANCA “3 HERONJTË 1 – Të rritur” dhe  
AMBULANCA “3 HERONJTË 2 – Të rritur”, SHKODËR**

*E lidhur sot me datën \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023, mes palëve:*

**BASHKIA SHKODËR** e përfaqësuar nga Kryetari **Z. Bardh Spahia** .

**QENDRA SHËNDETËSORE NR. 2 SHKODËR, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur”** me Nr NIPTI K76312011V, përfaqësuar nga **Z.Arbër METI**, me Nr. Personal I40810189N.

**BAZA LIGJORE:** Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet në bazë të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, VKM nr. 421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër”.

**OBJEKTI:** Dhënia në përdorim e një ambienti në objektin ish “Ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizime Sh.a”, Zona Kadastrale 8593, nr 7/24, ndërtesë me sipërfaqe shfrytëzimi 46,69 m<sup>2</sup> sipas planimetrisë bashkëlidhur, e regjistruar në pronësi të Bashkisë Shkodër, për të ushtruar aktivitetin: Dhënie Shërbimi Publik Shëndetësor Parësor.

*Palët bien dakort sa më poshtë:*

**NENI 1**

Bashkia Shkodër do t'i japë në përdorim Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur” pasurinë e përshkruar në objektin e

kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për ta përdorur për veprimtarinë e dhënies së shërbimit publik shëndetësor parësor .

## NENI 2

Afati i përdorjes së ambjenteve është 1 (një) vit, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, me të drejtë rinovimi .

## NENI 3

Prona e paluajtshme objekt i kësaj marrëveshje bashkëpunimi pasi është parë nga të dy palët për gjendjen e saj teknike dhe funksionale, merret në dorëzim nga përfaqësuesi i Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur”, i cili garanton se do ta dorëzojë atë si në gjendjen fillestare. Për çdo dëmtim të konstatuar, pala (Qendra Shëndetësore Nr.2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur” ) do të përgjigjet me vlerën e plotë të dëmit.

## NENI 4

Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur” do ta përdor objektin vetëm për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është realizuar kjo marrëveshje bashkëpunimi.

## NENI 5

Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur” merr përsiper të kujdeset për ruajtjen e ambjenteve nga vjedhjet, dëmtimet, zjarri etj, si dhe çdo detyrim tjetër i parashikuar nga dispozitat ligjore në fuqi. Ambjentet e marra në përdorim përbëhen nga 2 dhoma dhe banjo, me sipërfaqe shfrytëzimi prej 46,69 m<sup>2</sup>.

## NENI 6

**Të drejtat dhe detyrimet e Qendrës Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur” :**

1. Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur” detyrohet të mbajë dhe t'i ruajë ambjentet me përkujdesje.
2. Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 –Të rritur” nuk mund të përdorë ambjentet ndryshe nga përdorimi i caktuar në marrëveshjen e bashkëpunimit.
3. Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 –Të rritur” nuk mund t'ia japë një të treti ambjentet për përdorim pa pëlqimin e Bashkisë Shkodër.
4. Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 –Të rritur” është përgjegjëse për humbjen ose dëmtimin e ambjenteve objekt

i kësaj marrëveshje bashkëpunimi, përveç kur provon se humbja ose dëmtimi i sendit do të kishte ndodhur edhe në rast se nuk do të ishte dhënë në përdorim.

5. Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur” gjatë gjithë kohës së përdorimit të ambjenteve objekt i kësaj marrëveshje është e detyruar që të lidhë kontratat dhe paguajë me shpenzimet e veta detyrimet e faturave të energjise elektrike, ujit, në rast të kundërt do të ketë sanksione deri në prishjen e marrëveshjes së bashkëpunimit.
6. Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur” është e detyruar që të paguajë me shpenzimet e veta shërbimet e mirëmbajtjes së zakonshme të ambjenteve në përdorim përveç kur në marrëveshjen e bashkëpunimit është parashikuar ndryshe.

## **NENI 7**

### **Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Shkodër :**

1. Bashkia Shkodër jep në përdorim ambientin e ndodhur në objektin ish “Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizime Sh.a”, Zona Kadastrale 8593, nr 7/24, ndërtesë me sipërfaqe shfrytëzimi 46,69 m<sup>2</sup> e regjistruar në pronësi të Bashkisë Shkodër, për të ushtruar aktivitetin: Dhënie Shërbimi Publik Shëndetësor Parësor.
2. Kur Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur” nuk përmbush detyrimet e lartpërmendura, Bashkia Shkodër mund të kërkojë kthimin e menjehershëm të ambjentit, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar.
3. Nëse Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur” përdor ambjentet ndryshe nga sa është caktuar në marrëveshjen e bashkëpunimit ose nga natyra e tij dhe për një kohë me të gjatë se sa duhej, pergjigjet për humbjen e ndodhur edhe nga rasti fator, përveç kur provon se sendi do të humbiste njëlloj, si të mos përdorej ndryshe, si të ishte kthyer në kohën e caktuar në marrëveshjen e bashkëpunimit.
4. Kur mbaron afati i marrëveshjes së bashkëpunimit ose kur marrëveshja e bashkëpunimit zgjidhet para këtij afati, Qendra Shëndetësore Nr. 2, Ambulanca “3 Heronjtë 1 -Të rritur” dhe Ambulanca “3 Heronjtë 2 – Të rritur” është e detyruar t'i kthejë Bashkisë Shkodër ambjentet po në atë gjëndje në të cilën i ka marrë me ndryshimet e zakonshme të shkaktuara nga përdorimi i tyre, ose në gjëndjen e parashikuar në marrëveshjen e bashkëpunimit. Gjersa nuk provohet e kundërta prezumohet se ambjenti është marrë në gjëndje të mirë.

5. Bashkia Shkodër merr përsipër dorëzimin e objektit me anë të një procesverbali të nënshkruar nga palët e kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

#### **NENI 8**

Në rast se midis palëve do të lindin mosmarrëveshje, të cilat nuk do të mund të zgjidhen në mirëkuptim midis tyre, atëherë secila nga palët ka të drejtë t'i drejtohet organeve kompetente, në mbështetje të legjislacionit në fuqi për zgjidhje.

#### **NENI 9**

Në rast se ndonjë nga palët e kësaj marrëveshje bashkëpunimi pengohet të përmbushë të gjitha ose një nga pjesët të detyrueshme të saj të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi si pasojë e forcës madhore, kjo palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së forcës madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rrjedhin nga forcat madhore.

Pezullimi i ekzekutimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi si pasojë e forcës madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e forcës madhore.

#### **NENI 10**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi quhet e lidhur me nënshkrimin e saj nga palët.

#### ***Dispozita te fundit***

#### **NENI 11**

Çdo korigjim i marrëveshjes së bashkëpunimit pas nënshkrimit të saj e bën atë të pavlefshme.

Kjo marrëveshje bashkëpunimit u hartua në katër kopje origjinale, e cila pasi iu lexua palëve, u pranua dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të plotë e të lirë.

**Për Bashkinë Shkodër**

**Z. Bardh Spahia**  
**Kryetar**

**Për Qendrën Shëndetësore Nr.2,**

**Ambulanca "3 Heronjtë 1 -Të rritur" dhe  
Ambulanca "3 Heronjtë 2 – Të rritur"**

**Z. Arbër METI**  
**Drejtore**